



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

**OFROHET 1 (NJË) BURSË STUDIMI UNIVERSITARE /PASUNIVERSITARE NË
KINË, VITI AKADEMIK 2015-2016**

Në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit dypalësh në fushën e arsimit, Qeveria e Republikës Popullore e Kinës ofron 1 (një) bursë për studime universitare ose pasuniversitare në Universitetet Publike të Kinës, për vitin akademik 2015-2016.

Aplikantët duhet të paraqesin pranë Drejtorisë së Integritimit dhe Projekteve në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dokumentet sipas listës në vijim:

Për studime universitare:

1. Kërkesën me shkrim drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ku të specifikohet dega e studimit;
2. Vërtetimin e notave për tri vitet e shkollës së mesme. Ky vërtetim duhet të jetë i firmosur nga Drejtoria ose Zyra Arsimore e rrethit përkatës dhe nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;
3. Letrën e interesit ose një plan studimi për programin e studimit;
4. Një CV që përmban informacion ciklet e shkollimit dhe adresat e shkollave ku aplikanti ka studiuar;
5. Certifikata të ndryshme (të skanuara) për pjesëmarrje në konkurse ose olimpiada në nivel kombëtar ose ndërkombëtar;
6. Raportin mjekësor për aftësi studimi;
7. Fotokopjen e faqes së të dhënave të pasaportës;
8. Dëshminë e Penalitetit;
9. 4 fotografi

Për programet e studimit master/ studime të avancuara:

1. Kërkesën me shkrim drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ku të specifikohet fusha e studimit;
2. Një CV që përmban informacion për ciklet e shkollimit dhe adresat e shkollave ku aplikanti ka studiuar;
3. Kopjen e noterizuar të diplomës ose të ndonjë dokumenti të ngjashëm që vërteton mbarimin e programit të nivelit të parë të studimeve të universitare (bachelor) ose nivelit II të studimeve (Master Profesional/Master i Shkencave);
4. Letër rekomandimi nga shkolla ose vendi i punës në rast se aplikanti është i punësuar;
5. Letrën e interesi ose një plan studimi për programin e studimit;
6. Raportin mjekësor për aftësi studimi;
7. Fotokopjen e faqes së pasaportës;
8. Dëshminë e Penalitetit;
9. 4 fotografi

Për programet e studimit në muzikë ose artet e bukura, aplikantët duhet të kenë në dokumentacion një CD me interpretimet ose punimet e tyre (dy skeçe, dy piktura me ngjyra, etj)

Ministria e Arsimit dhe Sportit do të bëjë përzgjedhjen për kandidatin më të mirë që plotëson kushtet e aplikimit për bursën e ofruar nga Qeveria e Republikës Popullore e Kinës për në universitetet publike kineze.

Afati i fundit për dorëzimin e dokumenteve me postë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit është data 31 mars 2015.

Për një informacion më të hollësishëm lidhur me procedurën e aplikimit dhe përgatitjes së dokumentacionit, referojuni adresave në vijim të internetit:

www.csc.edu.cn.laihua ;

<http://en.csc.edu.cn/Laihua/newsdetailen.aspx?cid=66&id=3074>;

<http://en.csc.edu.cn/Laihua/universityen.aspx>;

<http://www.csc.edu.cn/studyinchina/universityen.aspx>;

DREJTORIA E INTEGRIMIT DHE PROJEKTEVE